

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E DREJTËSISË
KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësive të institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Dhjetor, 2023

COSP10: Shqipëria mbështet reformat dhe angazhimet globale antikorrupsion

11-15.12.2023: U zhvillua në Atlanta të SHBA-së, sesioni i 10-të i punimeve të Konferencës së Shteteve Palë të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit - UNCAC. Përfaqësues të 190 shteteve palë, udhëheqës politikë, ekspertë të organeve shtetërore dhe ekspertë të organizatave të shoqërisë civile u mbledhën bashkë për të diskutuar mbi politikën e marra, iniciativat shtetërore dhe të bashkëpunimit të ndërsjelltë në luftën kundër korrupsionit. Nismat e reja dhe promovimet e instrumenteve antikorrupsion ishin fokusi i diskutimeve në sesionin e 10-të dhe në panelet teknike të diskutimeve, gjithashtu. Delegacioni i Shqipërisë u kryesua nga Zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni. Në panelin e diskutimeve të përgjithshme të vendeve, Znj. Pirdeni paraqiti zhvillimet më të fundit të reformave antikorrupsion, angazhimin politik dhe të organeve shtetërore në luftë kundër korrupsionit. Shqipëria mori pjesë në panelet e diskutimit të organizuara nga UNODC, OSCE dhe TI me tematikë reformat antikorrupsion dhe vullneti politik, transparenca dhe kontrolli i partive politike si edhe edukimi kundër korrupsionit. Shqipëria dha votën pro pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në punimet e COSP10, mbështeti plotësisht deklaratën finale të Atlantës: promovimi i integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës në luftën kundër korrupsionit dhe u rreshtua në vendet bashkë-sponsorizuese të rezolutës së propozuar fillimisht nga shteti i Ganës, për "Barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në luftën kundër korrupsionit". Konferenca e vendeve palë të UNCAC mbledhet çdo dy vjet duke unifikuar qëndrimet dhe veprimet e shteteve kundër korrupsionit.



Më shumë informacion për COSP10 gjeni në këtë link:
<https://www.unodc.org/unodc/corruption/COSP/session10.html>

Java e Integritetit 2023; aktivitete, forume diskutimi, lancime botimesh, sesione për integritetin

04-15.12.2023: Edicioni V i fushatës më të madhe kombëtare, vjetore kundër korrupsionit, Java e Integritetit, u zhvillua prej fillimit të muajit dhjetor 2023 për disa ditë rresht. Ministria e Drejtësisë në rolin e një prej partnerëve primarë organizatorë zhvilloi një kalendar aktiviteteve duke bërë bashkë grupe interesi të fushave të ndryshme. Aktivitetet nisën me nënshkrimin *live* të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë - Ministrisë së Arsimit dhe Sportit - Ambasadës Italiane në Tiranë në datë 4.12.2023. Marrëveshja do të rrisë informimin dhe kulturën e ligjshmërisë dhe luftës kundër korrupsionit në klasat e 10-ta në 12 shkolla të mesme të Shqipërisë, për tre vite akademike. Nxënësit 15-vjeçarë do të bëhen përcjellësit më të mirë të nismave kundër korrupsionit dhe forcimit të denoncimit të rasteve korruptive.

Në bashkëpunim me partnerin kryesor të Javës së Integritetit, ICC Albania, u zhvillua konferenca shumëpalëshe "Bashkëpunimi për anëtarësim në BE: përforsimi i integritetit përmes veprimeve kolektive dhe mirëqeverisjes", ku drejtues politikë, politikë-bërës dhe përfaqësues nga sektori privat, academia dhe shoqëria civile, promovuan aktivitetet vjetore të procesit *screening* të Shqipërisë dhe diskutuan në panele teknike çështje që lidhen me sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, përparimin e Shqipërisë në procesin e anëtarësimit dhe praktikën e integritetit në biznes.



Shkolla e Integritetit, ishte aktiviteti që mbylli ditën e parë të Javës së Integritetit, ku *Transparency International* i Hollandës bashkë me Ministrinë e Drejtësisë dhe organizatën Boga & Associates në Tiranë, ofruan njohuritë më të fundit dhe diskutuan rreth rregullave të menaxhimit të rrezeve të korrupsionit dhe rasteve praktike të dilemave etike. Punonjës të administratës publike dhe praktikues të mekanizmave antikorrupsion ishin auditori i këtij sesioni.

Në ditën e dytë të fushatës (5.12.2023) u kujtua 20-vjetori i miratimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit. Ministria e Drejtësisë dhe UNODC promovuan në Tiranë dy botime udhëzues për praktikuesit e ligjit dhe të çështjeve antikorrupsion: (1) Udhëzuesi i Ndihmës së Ndërsjelltë Juridike dhe (2) Udhëzuesi i Përgjigjes së Veprimit të Shpejtë për Hetimin e Korrupsionit. Të dy botimet do të lehtësojnë aktivitetin dhe punën e autoriteteve ligjzbatuese dhe homologët e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme.



Dita e tretë e fushatës (6.12.2023) u shpëngul në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë në Tiranë. Ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të të Dhënave Personale dhe UNODC, dega rajonale e Ballkanit Perëndimor informuan studentët e ligjit mbi instrumentet e integritetit, mbi aksesin në informacionin publik, si mjet për të zbuluar të vërtetën dhe fuqizuar individët për t'u përballur me luftën kundër korrupsionit dhe të dhënat e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit. Takimi u moderua nga profesori i fakultetit, znj. Nadia Rusi. Takimi hodhi bazat e një platforme për të shkëmbyer mendime dhe përvoja me studentët, si praktikuesit e nesërm të ligjit dhe së drejtës.



Dita e katërt e fushatës (7.12.2023) bëri bashkë Ministrinë e Drejtësisë dhe sektorin privat e biznesin në forumin Partneriteti Antikorrupsion. Bashkëpunimi i biznesit me sektorin publik për të luftuar korrupsionin, rritjen e ndërgjegjësisë për rëndësinë e integritetit, transparençën në sektorin privat si dhe përmirësimin e praktikave të punës së biznesit ishin tematika e folësve në këtë forum që vendosën urat e komunikimit për të përmirësuar klimën e biznesit në vend.




Java e Integritetit 2023, nga Ministria e Drejtësisë u mbyll me sesionin e trajnimit për funksionarët politikë pranë ministrave (këshilltarët politikë) në datë 15.12.2023. Trajnimi me temë "Etika dhe integriteti për zyrtarët publikë", ofroi për anëtarët e kabinetit pranë ministrave njohuri, informim dhe analizë mbi tema që lidhen me integritetin, etikën dhe konfliktin e interesave. Sesioni u mundësua në bashkëpunim me prezencën e OSCE në Tiranë.



Të dhëna të detajuara për çdo aktivitet, video dhe foto mund të gjenden në profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion *LinkedIn, Facebook, Instagram, Twitter, Threats*.

Ekipi Tematik Teknik Antikorrupsioni konfirmon raportin e monitorimit 3M3 2023 të Planit të Veprimit Antikorrupsion

27.12.2023: Sekretariati teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka përfunduar monitorimin dhe ka hartuar raportin mbi zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion për 3M3 2023. Raporti është mbështetur në informacionin narrativ dhe statistikor të institucioneve zbatuese të planit të veprimit dhe është dakordësuar në takimin e Ekipit Tematik Teknik Antikorrupsion. Raporti merr në analizë nivelin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për zbatim për këtë periudhë të vitit, vlerëson ecurinë e progresit të veprimtarive të institucioneve por edhe evidenton masa për ndërhyrje. Disa rezultate të raportit përmenden: janë zbatuar plotësisht 30 masa, pjesërisht 10 masa dhe nuk janë zbatuar 16 masa si dhe janë zbatuar plotësisht 49 aktivitete, pjesërisht 6 aktivitete dhe të pazbatuara janë 38 aktivitete. Është instaluar regjistri elektronik i kërkesa dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit në 27 autoritete publike më shumë, APP ka hartuar dhe miratuar një rekomandim mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të




Bulevardi "Zog I-rë", Tiranë

<http://www.drejtesia.gov.al>

infoak@drejtesia.gov.al



kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër, AKSHI ka rritur numrin e shërbimeve në portalin unik qeveritar e-Albania, në 1231 shërbime, varësitë e ministrive të linjës kanë hartuar Planet e Integritetit. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka marrë në total 77 denoncime dhe ka konkluduar me 12 masa për fillimin e ecurisë disiplinore, 9 masa për largimin nga detyra, 33 rekomandime për institucionet publike dhe 4 kallëzime për ndjekje penale në organet e zbatimit të ligjit ndërkohë që janë programuar veprimet për rritjen e ndërgjegjësimit antikorrupsion. Raporti do të jetë pjesë përbërëse e raportit vjetor të monitorimit, gjithashtu.



Dhjetor 2023: Drejtoria Antikorrupsion propozon 8 masa disiplinore dhe 3 kallëzime penale për korrupsion

01-29.12.2023: Muaji i 12-të i vitit 2023 ka mbyllur aktivitetin e rregullt dhe intensiv të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, referuar rasteve dhe verifikimit dhe hetimit administrativ, të dyshuara të korrupsionit, në administratën publike. Nga të dhënat e marra në administrim dhe në përfundim të veprimeve procedurale të ndjekura nga specialistët e drejtorisë dhe koordinatorët e Rrjetit Kundër Korrupsionit, rezulton se janë përfunduar në total, 5 raporte përfundimtare nëpërmjet të cilave janë propozuar: 8 masa disiplinore dhe 11 rekomandime. Gjatë muajit dhjetor 2023 janë depozituar pranë organit të prokurorisë 3 kallëzime penale për 8 persona. Problematika janë shërbimet e organeve të administratës për publikun dhe qytetarët që janë në kontakt me to. Punonjësit e drejtorisë me kompetenca verifikuese dhe kontrolli janë në dispozicion të çdo rasti dhe akti denoncimi për të garantuar transparencë, veprimtari ligjore dhe në përputhje me procedurat administrative.

Denonconi raste dhe praktika abuzive, në adresën: koordinatoriak@drejtesia.gov.al



Shqipëria ndaj eksperiencën e saj në hartimin dhe monitorimin e instrumenteve antikorrupsion në rajon

20-22.12.2023: Shqipëria ndan eksperiencën e saj në hartimin dhe monitorimin e strategjisë kundër korrupsionit në Sarajevë të Bosnje dhe Hercegovinës. Me ftesë të zyrës së UNODC, dega e Ballkanit, staf teknikë i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion mori pjesë në takim me temë “Shkëmbimi i përvojave, qasjes dhe metodologjisë gjatë hartimit të strategjisë për luftën kundër korrupsionit në Bosnje dhe Hercegovinë”. UNODC po asiston autoritetet boshnjake në hartimin e paketës së re strategjike antikorrupsion dhe ofroi mundësinë e shkëmbimit të eksperiencës së Shqipërisë në këtë proces. Në takim u prezantuan metodologjia e ndjekur nga vendi ynë për monitorimin e planit të veprimit antikorrupsion dhe analizës së raportit gjithashtu. Praktika shqiptare në hartimin e strategjisë së re antikorrupsion 2024-2030, u prezantuan në takim si një prej praktikave më të mira të hartimit të akteve në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë. dha në takim. Pjesëmarrës në takim ishin edhe autoritete qeveritare nga organet ligjzbatuese dhe praktikantët e luftës kundër korrupsionit, në vendet e Ballkanit Perëndimor si Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Mali i Zi.



RAI mobilizon vendet e rajonit për bashkëpunim në kontrollin e deklarimit të pasurive

20.12.2023: Ministria e Drejtësisë mori pjesë në tryezën e rumbullakët rajonale “Ura për sisteme efektive të zbulimit të pasurive” zhvilluar në Shkup të Maqedonisë së Veriut. Tryeza u inicua nga organizata Iniciativa Rajonale Antikorrupsion - RAI. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të krijimit të bashkëpunimit të mundshëm në të ardhmen midis vendeve të rajonit, për kontrollin dhe verifikimin e pasurive të subjekteve publike që kanë detyrimin të deklarojë pasuritë dhe konfliktin e interesave. Ekspertiza teknike e RAI prezantoi një dokument të punuar për të gjithë vendet e rajonit: Deklarimi i Aseteve; Një mjet për parandalimin e korrupsionit, e cila mund të shërbejë si një tregues për vendet se si mund të monitorohet kontrolli i deklarimit të pasurive. Takimi u përmbyll me një angazhim të përbashkët të shprehur të pjesëmarrësve, për të mbështetur nismat kundër korrupsionit dhe forcuar bashkëpunimin rajonal. Takimi u ndoq edhe nga përfaqësues teknikë të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

